



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 14, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3, te Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e konform nenit 6, pika 3, lidhur me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15 dhe 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miratoi këtë:

## Projekt-V E N D I M

### Neni 1

1.1 **JEPET PËLQIMI-** për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1, (një) deri në 15, (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës parcela si më poshtë:

1.2 **Parcela,** kadastrale, me numër **P-72116046-02785-104**, sipas certifikatës Nr.1300-2025, të datës 13.01.2025 me sipërfaqe prej; **39156m<sup>2</sup>** nga sipërfaqja e përgjithshme prej; **177190m<sup>2</sup>** vendi i quajtur **“Shiroko”**, zona kadastrale Suharekë, pasurisë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, me destinim sipas vendimit të Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-16-7254 të datës 30.06.2015, është caktuar lokacion për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

### Neni 2

**OBLIGOHET-**Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, afatshkurtër, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Më datë\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit

\_\_\_\_\_  
Mr.ec Bexhet KUÇI